

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shërbim e organizim eventesh, pritje-përcjellje delegacionesh dhe material promovuese në lidhje me to”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **Shërbime të organizimit të eventeve kulturore - 79952100-3**

Mirëmbajtja e softwareve të teknologjisë së informacionit.

VLERA E FONDIT LIMIT: **5.000.000** (pesë milion) Lekë, pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Posta Shqiptare sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022 - 2023 - 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP dhe pikës 4 të nenit 54 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024). Pika 4: [..Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave..] dhe Gërmës c) [..40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme..] dhe të nenit 43 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar me Vendimin Nr.545, datë 4.9.2024) si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit që prokurohet

a) Në rastin e përvojës së mëparshme nga një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkojnë vërtetime të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim: Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se 30% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori Ekonomik në funksion të realizimit të shërbimit në kohë dhe sipas specifikimeve teknike, duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore

(Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

2.3.2. Operatori Ekonomik në funksion të realizimit të shërbimit në kohë dhe sipas specifikimeve teknike, duhet të ketë të punësuar minimalisht një staf prej 10 (dhjetë) punonjësish. Për të plotësuar këtë kriter duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën jo më pak se 3 (tre) muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore

(Kjo kerkese do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit. Operatori ekonomik i kualifikuar duhet të paraqesë përpara nënshkrimit të kontratës dokumentin e deklaruar si më lart).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Vendosja e numrit të punonjësve, jo më pak se 10 punonjës është vendosur duke patur parasysh grafikun e ekzekutimit të kontratës (5 (pese) dite), nevojën për montim dhe çmontim të skenës dhe infrastrukturës së eventit, si dhe realizimin në kohë të të gjitha elementëve të përcaktuar në **specifikimet teknike** të dokumenteve të tenderit. Ky kapacitet njerëzor konsiderohet minimal për të garantuar që operatori ekonomik ka aftësinë reale për të përmbushur me sukses dhe pa vonesa objektin e prokurimit.

2.3.3 Operatori Ekonomik Ofertues, duhet të paraqesë në procedurën e prokurimit publik çertifikatat përkatëse të vlefshme të ISO-ve, si më poshtë, ose ekuivalente, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

- **ISO 9001:2015** “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë” /ekuivalente.
- **ISO 14001-2015** “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” / ekuivalente

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë / ekuivalente

Ky certifikim garanton që operatori ekonomik ka struktura menaxhimi që sigurojnë cilësi të lartë në ofrimin e shërbimeve. Në kushtet e këtij prokurimi, që përfshin organizimin e një eventit ndërkombëtar me pjesëmarrje zyrtare, posedimi i ISO 9001 siguron realizimin e shërbimit me standard profesional, koordinim efikas dhe menaxhim të duhur të kohës dhe burimeve.

ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor / ekuivalente

Ky standard lidhet me minimizimin e ndikimeve mjedisore të veprimtarisë. Duke qenë se aktiviteti përfshin transport, akomodim dhe përdorim materiale, kërkesa për këtë certifikim garanton që operatori ekonomik e ushtron shërbimin në përputhje me parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të qëndrueshëm.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë me shkrim për garantimin e realizimit të aktivitetit sipas të gjitha specifikimeve teknike.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që vërtetojnë, se ata zotërojnë kapacitetin për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Në këtë rast, për shkak të kompleksitetit dhe rëndësisë së aktivitetit të parashikuar, deklarimi me shkrim nga OE për realizimin e të gjitha specifikimeve teknike shërben si angazhim paraprak që garanton seriozitetin e ofertës dhe përgatitjen për përmbushjen e kontratës në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike të procedurës për Specifikimet teknike të procedurës për “**Blerje Shtypshkrime**”, janë hartuar mbi bazën e **Urdhërit Nr. 35/1**, datë **24.07.2025**, të Administratorit të Posta Shqiptare sh.a., në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe nenit 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (ndryshuar).

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Vlera Limit e kontratës, duke qenë se nuk ka çmime të botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse, grupi i punës i ngritur me urdhërin e administratorit **nr. 59**, datë **24.07.2025**, u bazua në çmimet e tregut, e bazuar në nenin 76

“**Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar) ku parashikohet se:

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) **studimit të tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

*Bazuar në germen b) të pikes 1, të nenit 76 “**Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit**”, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimeve Publike” (i ndryshuar), grupi i punës, ka realizuar **studimin e tregut**, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; dokumentacion i cili gjendet në dosjen e tenderit dhe ka përlllogaritur vlerën limit të kontratës.*

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta per kualifikim jane hartuar nga strukture e posacme e ngritur me urdher te titullarit te autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: